REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr6572Prot Maliq, më 02.11.2026

VENDIM

Nr. 128, datë 30.10.2026

Për
"Disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë", i ndryshuar"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "*Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë",* i ndryshuar,

VENDOSI:

I. Të miratoj disa ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Maliq si më poshtë:

1- Në strukturën e Administratës së Bashkisë Maliq (qëndër), në lidhja nr. 1 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

- Në "*Drejtorinë e të Ardhurave*", pozicioni i punës ***"Nëpunës taksash (kontratë) Libonik***", pranë Sektorit të Kontrollit të Tatimpaguesve në Territor, të ndryshohet dhe të bëhet: "***Nëpunës Inspektor Tatimor Libonik***", Klasa "VI-3", me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **55.000** (*pesëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

2- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në lidhja nr. 5 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

- Në "*Sektorin e Mirëmbajtje Objekte Publike*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës ***"Punëtor mirëmbajtje"***, me nr. rendor 26 në këtë drejtori, Klasa "Pika 11", paga për

pozicion bëhet në masën **50.000** (*pesëdhjetë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 8 orë pune;

II. Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

III. Për nxjerrjen e urdhrit për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.11.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ